

## RELACION

### PËR PROJEKTLIGJIN

#### PËR DËSA NË TESA NË LIGJIN NR. 9244, DATË 17.6.2004, "PËR MBROJTJEN E TOKËS BUJQËSORE", TË NDRYSHUAR"

Në periudhën më të madhe të vitit, vendi përballët me zjarre të shumta. Përveçse në pyje e kullota, zjarret janë mjaft problematike në tokat bujqësore, veçanërisht gjatë verës ku edhe fluksi i vizitorëve është maksimal. Zjarret shpeshherë ndizen edhe në afërsi të institucioneve të ndryshme, rrugëve dhe qendrave të banuara duke rrezikuar seriozisht jetën e gjithkujt.

Qëllimi i propozimit të këtij akti ligjor është ndalimi njëherë e mirë i këtyre krimeve mjedisore, dëmtuese të gjithçkaje mbi e nën tokë, ashtu siç kanë bërë vendet evropiane.

Arsyet e kësaj nisme janë si vijon::

- Fluksi më i madh i turizmit në vend ndodh gjatë periudhës së verës. Mirëpo, gjatë kësaj periudhe (Mars-Nëntor) fermerët zgjedhin mënyrën më të shkurtër, më anti-mjedisore dhe më të rrezikshme për jetën dhe pronën – djegien e tokave bujqësore.
- Zjarri krijon një imazh tejet negativ për vendin. Veçanërisht vizitorët e huaj të cilët nuk janë mësuar me pamje të tilla me zjarre e tym ngado, nuk e pranojnë që në periudhën më të rëndësishme të vitit ku ata duan të shijojnë pushimet, të përballen me ato pamje që ngjajnë si zona lufte.
- Zjarret dekurajonë çdo lloj vizitori që dëshiron të vijë në vend. Në këtë mënyrë imazhi i vendit në sytë e vizitorëve të huaj bëhet tërësisht negativ.
- Është e rrezikshme për shëndetin, pasi zjarret në pamundësi për tu kontrolluar, kanë rezultuar fatale edhe për vetë personat duke ju marrë jetën.
- Zjarri përveçse tokave bujqësore që digjen, rrezikon edhe pronat e tjera përreth apo në afërsi, duke djegur ato, përfshirë edhe banesat apo rrezikuar gjithëka tjetër përreth.
- Shumë zjarre në pyje vijnë nga djegia e tokave bujqësore.
- Zjarret janë një problem i madh mjedisor, duke ndotur jo vetëm zonën ku ndodh djegia, por edhe atmosferën në përgjithësi, përmes shkakimit të gazeve serë (CO<sub>2</sub>).
- Zjarret bëhen shkas për bllokimin e rrugëve apo aksidente rrugore. Djegia e tokave në afërsi të akseve rrugore kufizon pamjet dhe rrezikon jetën e drejtuesve të mjeteve dhe pasagjereve.
- Zjarret, kështu siç shfaqen në Shqipëri, krijojnë imazhin e një vendi i cili nuk kontrollon dot territorin e tij.
- Zjarret janë shkatërruese të mjedisit tonë, florës dhe faunës.

Ky projektligj ka kontributin e një grupi specialistësh të fushës, të angazhuar për një kohë të gjatë.

Propozimi nuk ka kosto financiare që ngarkojnë buxhetin e shtetit me shpenzime plus. Po ashtu, nuk ka kosto as për fermerët, pasi ekzistojnë alternativa për përparimin dhe kthimin e mbetjeve të

...niveu për punë dhe veshiave në bio-energji, pra nga një element ndotës, në një element  
përfundim për fermerin dhe vendin.